Agjencia e Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele

# PRONËSIA E MEDIAS

# NË VITIN 2026

## PËRMBAJTA

HYRJE ........ 5
TLEVIZIONET TOKËSORE NË NIVEL SHTERËROR ........ 7
TELEVIZIONET NË NIVEL SHTETËROR PËRMES RESURSI TË PAKUFIZUAR ........ 13
TELEVIZIONET NË NIVEL RAJONAL ........ 17
TELEVIZIONET NË NIVEL LOKAL ........ 20
RADIOSTACIONET NË NIVEL SHTETËROR ........ 21
RADIOSTACIONET NË NIVEL RAJONAL ........ 23
RADIOSTACIONET NË NIVEL LOKAL ........ 25
NDRYSHIME NË STRUKTURËN PRONËSORE TË TRANSMETUESVE NË VITIN 2025 ........ 31
STRUKTURA PRONËSORE E BOTUESVE TË MEDIAS SË SHTYPIT ........ 32
STRUKURA PRONËSORE E BOTUESVE TË MEDIAS ONLINE – INTERNET PORTALIT ........ 37
BOTIMI DHE LIDHSHMËRIA E PRONËSISË SË MEDIAS ........ 49

# HYRJE

Publikimi përmban të dhëna për strukturën pronësore të radiodifuzerëve (gjithsej 91 – 35 televizione dhe 56 radio), botues të medias së shtypit (gjithsej 19) dhe botues të medias online – portalalit të internetit (gjithsej 50) që janë të evidentuar në regjistrin e mbajtur nga Agjencia e Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Për të ofruar një pasqyrë të plotë të pronësisë, publikimi ofron një pasqyrë të pronësisë deri te bartësi përfundimtar i pjesës pronësore në këto subjekte.

Qëllimi i këtioj dokumenti, të cilin Agjencia e ka përgatitur rregullisht që nga viti 2019, është të sigurojë transparencë më të madhe të pronësisë së medis, përkatësisht informim më të mirë të publikut rreth strukturës pronësore të medias.

## TLEVIZIONET TOKËSORE NË NIVEL SHTERËROR

Program në nivel shtetëror përmes transmetuesi tokësor, transmetojnë televizionet Alfa, Alsat-M, Telma, Sitel dhe Kanal 5.

### 1. TV Alfa

TV Alfa është në pronësi të plotë të personit juridik – Shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar për qarkullim dhe shërbime ALFA SKOP ShPK eksport-import Shkup.

Pronarë të kësaj shoqërie paraqiten katër persona juridik, nga ku pjesë më të madhe prej 56.90 % të kapitalit bazë e ka Shoqëria e shërbimeve CHS INVEST GROUP ShPK Shkup. Pronari i fundit i CHS INVEST GROUP është personi fizik Petar Schatz nga Hungaria, i cili e posedon plotësisht dhe personi i dytë juridik si pronar i drejtpërdrejë i ALFA SKOP ShPK eksport-import Shkup, e cila është Shoqëria për tregti dhe shërbime TARGET MEDIA ShPKNjP Shkup. Indirekt, përmes CHS INVEST GROUP dhe përmes TARGET MEDIA së bashku, Peter Schatz posedon 71.64 % të kapitalit të ALFA SKOP.

27,54 % i posedojnë dy shoqëri aksionare, dhe atë: 16,69 % Shoqëria tregtare e shpedicionit ndërkombëtar, magazinim, tregti të jashtme, prodhimtari dhe qarkullim MAKOSHPED ShA nga Shkupi dhe 10,85 % Shoqëria aksionare fabrika e çokollatës, vafer dhe karamele EVROPA - Shkup. Aksioneri më i madh në MAKOSHPED ShA[1], i cili posedon 19,03 % të aksioneve është Shoqëria tregtare për tregti me shumicë dhe pakicë MEPKOM

---

[1]Aksionerë të tjerë me mbi 5 % aksione në MAKOSHPED Ash janë: UGOTUR Shoqëri aksionare për tregti, shërbime dhe punë agjencie – Shkup (18.90 %), Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime IGM-TREJD Ilija dhe shp. ShPK (12.93 %) dhe Shoqëria tregtare e shpedicionit ndërkombëtar, magazinim, tregti të jashtme, prodhim dhe qarkullim MAKOSHPED ShA (10 %) – Të dhënat janë siguruar nga faqja e internetit e Depozituesit Qendror të Letrave me Vlerë https://www.cdhv.mk/акционери_над_5_.aspx#, gjendja me datë 6.4.2026, qasje më datë 9.4.2026.

Koço dhe ShPK të tjera eksport-import, ndërsa aksioner më i madh në EVROPA ShA[2] është Shoqëria e shpedicionit të brendshëm dhe të jashtëm me magazina publike dhe doganore FERSHPED ShA me 21,77 % të aksioneve.




[2] Aksionerë të tjerë me mbi 5 % të aksioneve në ShA EVROPA janë: Shoqëria tregtare e shpedicionit ndërkombëtar, magazinim, tregti e jashtme, prodhim dhe qarkullim MAKOSHPED ShA (19,90 %), Shoqrëria për tregti, prodhim dhe shërbime AS SENjak eksport-import Sellaudin Arifi ShPKNjP (19,15 %), Shoqëria aksionere fabrika e çokollatave, vafer dhe karameleve EVROPA (10 %), Milla Leçentiç (8,68 %) dhe Esamedin Hasani (6,25 %) – Të dhënat janë siguruar nga faqja e internetit të Depozitit Qendror të Letrave me Vlerë, https://www.cdhv.mk/акционери_над_5_.aspx#, gjendja më 6.4.2026, qasje më 9.4.2026.

## 2. TV Alsat-M

TV Alsat-M është në pronësi të drejtpërdrejtë të një personi juridik dhe një personi fizik. Pronari kryesor është personi juridik – Shoqëria për prodhim, inxhinieri, konsulencë, tregti dhe shërbime VEVE GROUP ShPK nga Shkupi, pronarë të së cilës janë personat fizikë Ferik Velija (88 %) dhe Zana Velija (12 %).




## 3. TV Telma

TV Telma është në pronësi të MAKPETROL Shoqërisë aksionare për qarkullim (tregti) të naftës dhe derivate të naftës Shkup, struktura e së cilës dominohet nga dy aksionarë të mëdhenj, pra dy pronarë me mbi 5 %.

aksione – Shoqëri komanditore me aksione për transport OILKO Shkup (27.95% të aksioneve) dhe MAKPETROL ShA (10 % të aksioneve)[3].




Përveç këtyre, aksione në MAKPETROL ShA kanë edhe 2.355 subjekte, nga të cilat 2.318 janë vendase dhe 37 janë subjekte të huaj juridike dhe fizikë.

Tabela 1: Numri i aksioneve dhe aksionarëve në MAKPETROL ShA (gjendja më 20.4.2026)

| **Lloji i aksionerëve** | | **Numri i aksioneve** | **Numri i aksionarëve** |
|---|---|---|---|
| Vendas | personat juridik | 53.369 | 75 |
| | personat fizik | 57.629 | 2.245 |
| Të huaj | personat juridik | 264 | 7 |
| | personat fizik | 1.120 | 30 |
| **Në total** | | **112.382** | **2.357** |

[3] Depozituesi Qendror i Letrave me Vlerë, https://www.cdhv.mk/акционери_над_5_.aspx#, gjendja më 20.4.2026, qasje më 20.4.2026.
Aksionarët me mbi 5 % të aksioneve (gjendja më 20.4.2026) në OILKO janë: Makpetrol Shoqëria aksionare për qarkullim të naftës dhe derivateve të naftës (35.61 %), Andreja Josifovski (14.96 %) dhe Shoqëria komandite me aksione për transport OILKO Shkup (5.99 %)

## 4.TV Sitel

Pronari i vetëm i TV Sitel është Shoqëria Tregtare MONTEKO ShPKNjP eksport-import nga Shkupi, e cila është në pronësi të plotë të personit fizik Goran Ivanovski.



## 5.TV Kanal 5

Kanal 5 është i vetmi televizion tokësor në nivel shtetëror që është në pronësi të plotë të personit fizik. Duke filluar nga shtatori i vitit 2017, pronari i këtij transmetuesi është Emill Stojmenov.




Në pesë vitet e fundit, ndryshim në strukturën pronësore ka kryer vetëm TV Alsat-M. Në korrik 2024, nga pronësia e këtij televizioni u tërhoq personi fizik Imihane Velija, me pjesëmarrje në pronësi prej 0.07 %.

Tabela 2: Struktura pronësore e televizioneve tokësore në nivel shtetëror në pesë vitet e fundit

<table>
<tr><th>TV</th><th>2022</th><th></th><th>2023</th><th>2024</th><th>2025</th><th>2026</th></tr>
<tr><td>TV Alfa</td><td></td><td colspan="5">ALFA SKOP ShPK eksport-import Shkup – 100 %</td></tr>
<tr><td>TV Alsat-M</td><td></td><td colspan="2">Ferik Velija - 0,07 %<br>Imihane Velija - 0,07 %<br>VEVE GROUP ShPK, Shkup - 99,86 %</td><td colspan="3">nga korriku 2024<br>Ferik Velija - 0.14 %<br>Shoqëria e prodhimit, inxhinierisë, konsulencës, tregtisë dhe shërbime VEVE GROUPShPK, Shkup - 99.86 %</td></tr>
<tr><td>TV Telma</td><td></td><td colspan="5">MAKPETROL Shoqëri Aksionare për Tregti me Naftë dhe Derivate të Naftës Shkup – 100 %</td></tr>
<tr><td>TV Sitel</td><td></td><td colspan="5">Shoqëria tregtare MONTEKO ShPKNjPL eksport-import Shkup – 100 %</td></tr>
<tr><td>TV Kanal 5</td><td></td><td colspan="5">Emil Stojmenov – 100 %</td></tr>
</table>

## TELEVIZIONET NË NIVEL SHTETËROR PËRMES RESURSI TË PAKUFIZUAR

Leje për transmtimin e programit televiziv në nivel shtetëror përmes resursi të pakufuzuar kanë katër televizione, përkatësisht: Kompania 21-M dhe Shenja për transmetim përmes operatori të rrjetit publik të komunikimit elektronik, dhe 24 Vesti dhe Nasha TV për transmetim përmes satelitit. Nga këto, vetëm Nasha TV është në pronësi të personi fizik.

### 1. TV Kompani 21-M

Pronarët e Kompanisë Televizive 21-M janë katër persona fizikë nga Kosova, të cilët në pronësi të transmetuesit hyjnë përmes një personi tjetër juridik - Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar 21 ShPK nga Prishtina.

Pronari i fundit i më shumë se gjysmës (60 %) të kapitalit të Kompanisë Televizive është Afërdita Kelmendi. Personi Eugen Saraçini posedon 20 %, dhe pronarë me 10 % secili janë Florin Kelmendi dhe Xheraldina Vula.



## 2. TV Shenja

Pronari i fundit i TV Shenjës është personi Taxhudin Shabani, ndërsa pronari i drejtpërdrejtë është personi juridik Shoqëria për Tregti dhe Shërbime MEDIA VORLD NEVS ShPKNJP nga Shkupi. Pronari i vetëm i kësaj shoqërie është person tjetër juridik - Fondacioni për kulturë dhe arsim KULT VIZIONI nga Shkupi.



## 3. TV 24 Vesti

Pronari i vetëm i këtij televizioni është person juridik i huaj i regjistruar në Serbi. Bëhet fjalë për KOMNET 328 ShPK Beograd, i cili është në pronësi të plotë të personi fizik vendas.



## 4.Nasha TV

Pronari i vetëm i Nasha TV është personi fizik Risto Gogovski. Pronësinë e ka fituar që nga themelimi i transmetuesit në vitin 2008.




Në periudhën nga viti 2022 e këtej, ndryshim i pronësisë është kryer vetëm në TV 24 Vesti (në vitin 2024). Nga pronësia e televizionit plotësisht u tërhoq personi juridik Xhable 24 ShPK nga Linc Austri, dhe hyri personi juridik KOMNET 328 ShPK nga Beogradi, Sërbi.

Tabela 3: Struktura pronësore e televizioneve në nivek shtetëror përmes resursi të pakufizuara në pesë vitet e fundit

| TV | 2022 | 2023 | 2024 | 2025 | 2026 |
|---|---|---|---|---|---|
| TV Kompani 21-M | Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar Kompani 21 ShPK Prishtinë, Kosovë – 100 % | | | | |
| TV Shenja | Shoqëri për tregti dhe shërbime MEDIA VORLD NEVS ShPKNjP Shkup – 100 % | | | | |
| TV 24 Vesti | Xhable 24 ShPK Linc, Austri – 100 % | | nga shkurti 2024 Komnet 328 ShPK Beograd – 100 % | | |
| Nasha TV | Risto Gogovski – 100 % | | | | |

* Të dhënat mbi pronarin e këtij subjekti juridik ofrohen nga dokumenti i regjistrimit që TV 24 Vesti ia dorëzoi Agjencisë në vitin 2025. Në vitin 2026, transmetuesi nuk dorëzoi dokument të tillë.

## TELEVIZIONET NË NIVEL RAJONAL

Si pronarë të 12-të televizioneve rajonale janë paraqitur në total 14 subjekte - 12 individë dhe dy persona juridik.

Dhjetë stacione televizive janë në pronësi të një personi, dhe dy televizione kanë nga dy pronarë. Njëri është TV Star, ku pronari kryesor me 90 % të aksioneve është personi Hristijan Marjanov, dhe 10 % e pronësisë është në pronësi të personit Rozetka Monevska. I dyti është TV Kobra, ku pronarët - Lençe Litajkovska dhe Igor Litajkovski janë pjesëmarrës të barabartë prej 50 % të kapitalit të stacionit televiziv.

Në pronësi të personave juridikë janë televizionet M NET-HD dhe Era.

### 1. TV M HET-HD

Pronarë të fundit të TV M NET-HD janë personat fizikë Goran Hristovski, Blagoj Sersemov dhe Trajçe Andonov, secili me pjesëmarrje prej 33.3 % të aksioneve, të cilat i posedojnë në mënyrë indirekte, përmes Shoqërisë për tregti, prodhim dhe shërbime M NET-HD ShPK eksport-import. Shtip.



## 2.TV Era

Pronësia e këtij televizioni është identike me pronësinë e TV Shenja. Përkatësisht, pronari i vetëm i TV Era është Shoqëria për tregti dhe shërbime MEDIA VORLD NEVS ShPKNJP Shkup, e cila është në pronësi të plotë të Fondacionit për kulturë dhe arsim KULT VIZIONI Shkup. Pronari i fondacionit, dhe njëkohësisht pronari përfundimtar i televizionit, është personi fizik Taxhudin Shabani.




Tre televizione rajonale kanë kryer ndryshim të pronësisë në pesë vitet e fundit - Shutel (dy herë), Vistel dhe Prva Skopska (TV MTM). Bëhet fjalë për ndryshimet në vijim:

1. Në mars të vitit 2022, nga pronësia e TV Shutel u tërhoq personi fizik Valentin Bajrami dhe hyri personi Enver Iljazi.Televizioni zbatoi ndryshim në strukturën pronësore dhe në vitin pasardhës 2023, me tërheqjen e Enver

Iljazit dha hyrjen e Antonie Stojçeski si pronar i vetëm (TV Shutel kërkoi pëlqimin e AShMA-së për ndryshim të pronarëve në nëntor 2025, por ndryshimi i propozuar, i cili u miratua nga AShMA-ja, nuk u zbatua);

2. Në shkurt të vitit 2024, nga pronësia e TV Vistel u tërhoq Shoqëria për prodhim, turizëm, qarkullim dhe shërbime PREOBRAZBA ShPKNjP Shkup, dhe hyri personi fizik Petar Karevski;
3. Në prill të vitit 2025, u zbatua ndryshim i pronarëve të Prva Skopska TV, në atë mënyrë që personi Gordana Andreevska u tërhoq plotësisht nga pronësia, dhe hyri personi Nikolla Tasev.

Tabela më poshtë tregon pronarët e të gjitha 12 stacioneve televizive rajonale në pesë vitet e fundit.

Tabela 4: Struktura pronësore e televizioneve rajonale në pesë vitet e fundit

| TB | 2022 | 2023 | 2024 | 2025 | 2026 |
|---|---|---|---|---|---|
| TV Tera | Zoran Mangovski – 100 % | | | | |
| TV Star | Hristijan Marjanov – 90 % dhe Rozetka Monevska – 10 % | | | | |
| TV Kobra | Lençe Litajkovska – 50 % dhe Igor Litajkovski – 50 % | | | | |
| TV Topestrada | Vigan Ibishi – 100 % | | | | |
| TV M NET-HD | M NET-HD ShPK eksport-import Shtip – 100 % | | | | |
| TV Vistell | / | PREOBRAZBA ShPKNjP Shkup 100 % | nga shkurti 2024<br>Petar Karevski – 100 % | | |
| TV Edo | Enes Babaçiq – 100 % | | | | |
| TV Era | MEDIA VORLD NEVS ShPKNjP Shkup – 100 % | | | | |
| TV Prva Skopsko | Gordana Andreevska – 100 % | | | nga prilli 2025<br>Nikolla Tasev – 100 % | |
| TV Shutel | deri në Mars 2022<br>alentin Bajram – 100 %<br>nga Marsi 2022<br>Enver Iljazi 100 % | nga qershori 2023<br>Antonie Stojçeski – 100 % | | | |
| TV KTV | Angell Danov – 100 % | | | | |
| TV Koha | Mevaip Abdiu - 100 % | | | | |

## TELEVIZIONET NË NIVEL LOKAL

Të gjitha stacionet televizive lokale (gjithsej 14) janë në pronësi të personave fizik.

Më shumë se një pronar kanë vetëm dy televizione – TV Svet dhe TV Plus. Pronarët e TV Svet janë personat Dragan Deçkov, me pjesëmarrje prej 51 % të aksioneve, dhe Gjorgi Deçkov, me pjesëmarrje prej 49 % të kapitalit bazë të televizionit. Në TV Plus, pronarja kryesore është Ivana Spasovska, e cila posedon 66.7 % të kapitalit të televizionit, dhe pronari i pjesës së mbetur prej 33.3 % është Risto Ilievski.

Në periudhën nga viti 2022 e tutje, vetëm TV Gurra ka pësuar ndryshim të pronarëve. Konkretisht, ndryshimi u realizua në fund të vitit 2024, ku nga pronësia u tërhoq personi Merita Adilji dhe hyri personi Kastriot Iseinoski.

Tabela 5: Struktura pronësore e televizioneve lokale në pesë vitet e fundit

| TV | 2022 | 2023 | 2024 | 2025 | 2026 |
|---|---|---|---|---|---|
| TV Festa | Nexhati Aqifi – 100 % | | | | |
| TV K | Lazo Dimitrov – 100 % | | | | |
| TV Protell | Çedo Petrov – 100 % | | | | |
| TV Svet | Dragan Deçkov – 51 % dhe Gjorgi Deçkov – 49 % | | | | |
| TV Kaltrina | Mazar Tateshi – 100 % | | | | |
| TV Spektra | Demish Karimanoski – 100 % | | | | |
| TV Dibra | Ilir Lela – 100 % | | | | |
| TV Gurra | Merita Adilji – 100% | | nga dhjetori 2024<br>Kastriot Iseinoski – 100 % | | |
| TV Due | Nazmi Elezi – 100 % | | | | |
| G-Tv | Blerim Mustafi – 100 % | | | | |
| TV Plus | Ivana Spasovska - 66,7% dhe Risto Ilievski - 33,3 % | | | | |
| TV Uskana media | Munir Mehdiu – 100 % | | | | |
| TV Njuz | Amir Hamiti – 100 % | | | | |
| TV Horizont | / | | | | Petar Georgieski – 100 % |

## RADIOSTACIONET NË NIVEL SHTETËROR

Nga katër radiostacionet që transmetojnë në nivel shtetëror, vetëm Kanal 77 është në pronësi të personi juridik – Shoqërisë për tregti, shërbime, marketing dhe informacion GBC KOMUNIKACII ShPKNJP Shtip. Pronari përfundimtar i radios është personi fizik Viktor Gavrillov.

### RA Kanal 77




Pronarë të Antena 5 janë Zoran Petrov, Marjan Gushev dhe Kosta Janevski, ku secili prej tyre posedon pjesë identike të pronësisë së radios (secili 33.3 % ).

Metropolis dhe Jon Radio kanë secili nga dy pronarë.

Metropolis është në pronësi të Darko Gelev (50.04 %) dhe Mile Gjoshevskit (49.96 %), ndërsa Jon Radio është në pronësi të Goce Stojkovskit (62.5 %) dhe Fisnik Tateshit (37.5 %).

Ndryshim të strukturës pronësore në pesë vitet e fundit ka kryer vetëm Jon Radio, në mars të vitit 2023, ku nga pronësia u tërhoq personi Andrej Stojkov dhe pjesa e tij prej (25 %) iu transferua personit Goce Stojkovskit. Pas zbatimit të ndryshimit, Goce Stojkovski u bë aksionar kryesor i radiostacionit.

Tabela 6: Struktura pronësore e radiostacioneve në nivel shtetëror në pesë vitet e fundit

| rA | 2022 | 2023 | 2024 | 2025 | 2026 |
|---|---|---|---|---|---|
| RA Kanal 77 | Shoqëria për tregti, shërbime, marketing dhe informim GBC KOMUNIKACII ShPKNJP Shtip– 100 % | | | | |
| RA Antena 5 | Zoran Petrov – 33,3 %, Marjan Gushev – 33,3 % dhe Kosta Janevski – 33,3 % | | | | |
| RA Metropolis | Darko Gelev - 50,04 % dhe Mile Gjoshevski - 49,96 % | | | | |
| RA Jon | Goce Stojkovski - 37,5 %<br>Fisnik Tateshi - 37,5 %<br>Andrej Stojkov – 25 % | nga marsi 2023<br>Goce Stojkovski - 62,5 % dhe Fisnik Tateshi - 37,5 % | | | |

## RADIOSTACIONET NË NIVEL RAJONAL

Pronarët e radiostacioneve rajonale janë 15 persona fizik dhe një person juridik, i cili posedon RA 99. Konkretisht, pronari i vetëm i RA 99 është Shoqëria për tregti, prodhim, bujtinari dhe shërbime UMAJA-BT ShPKNjP nga Shkupi, dhe pronari i saj është personi fizik Sejjid Emin.

**RADIO 99**




Në periudhën nga viti 2022 e tutje, u krye ndryshim i pronarëve të: RA 99 (në dhjetor 2023), RA Urban FM (në maj 2023), RA Lajf (në nëntor 2023) dhe RA Xhez FM (në nëntor 2023 dhe janar 2024). Në fillim të vitit 2026, AShMA miratoi ndryshim në strukturën pronësore të RA Vat, por ky ndryshim nuk u zbatua në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

1. Me ndryshimin e strukturës pronësore të RA 99, nga pronësia e radios u tërhoq personi fizik Muarem Ismaili dhe hyri personi juridik UMAJA-BT ShPKNjP nga Shkupi.

2. Ndryshimi në RA Urban FM u realizua në mënyrën që personi Mitko Arnaudov u tërhoq dhe hyri personi Robin Zimbakov, si pronar i vetëm i radiostacionit.
3. Ndryshimi në strukturën pronësore të RA Lajf ndodhi për shkak të vdekjes së pronarit, në të cilën pjesa e pronësisë iu transferua personit Aferdita Fetau.
4. RA Xhez FM ka kryer ndryshim dy herë në pesë vitet e fundit. Me ndryshimin e parë, për shkak të vdekjes së pronarit, pronari i ri u bë Alen Haxhi-Stefanov. Me ndryshimin e dytë, nga pronësia plotësisht u tërhoq Alen Haxhi-Stefanov dhe hyri personi Darko Fidanoski.

Pronarët e të gjitha radiostacioneve rajonale janë paraqitur në tabelën më poshtë.

Tabela 7: Struktura pronësore e radiostacioneve rajonale në pesë vitet e fundit

| RA | 2022 | 2023 | 2024 | 2025 | 2026 |
|---|---|---|---|---|---|
| RA 99 | Muarem Ismaili 100 % | nga dhjetori 2023<br>UMAJA-BT ShPKNJP Shkup - 100 % | | | |
| RA Buba Mara | Ranko Petroviq – 100 % | | | | |
| RA Vat | Mefail Kadri – 50% dhe Ekrem Kadri – 50 % | | | | |
| RA Zona M-1 | Svetllana Tasevska – 100 % | | | | |
| RA Urban FM | Mitko Arnaudov 100 % | nga maji 2023<br>Robin Zimbakov – 100 % | | | |
| RA Klub FM | Gjorgji Savev – 34 % dhe Elena Petreska – 66 % | | | | |
| RA Lajf | Kreshnik Ajdini 100 % | nga nëntori 2023<br>Aferdita Fetau – 100 % | | | |
| RA Rosa AB | Aleksandar Dimitrov – 100 % | | | | |
| RA RFM | Risto Gogovski – 100 % | | | | |
| RA Siti | Darko Gelev – 100 % | | | | |
| RA Skaj | Teodor Maneski – 100 % | | | | |
| RA Sportsko 90,3 | Toni Mitev – 100 % | | | | |
| RA Fortuna | Violeta Bozhinoska – 100 % | | | | |
| RAXhez FM | Ljupço Haxhi Stefanov – 100 % | nga nëntori 2023<br>Alen Haxhi Stefanov – 100 % | nga janari 2024<br>Darko Fidanoski – 100 % | | |

## RADIOSTACIONET NË NIVEL LOKAL

Nga 38 radio lokale, 32 janë në pronësi të personave fizik, pesë janë në pronësi të personave juridikë, dhe një (radio studentore UKLO FM) funksionon si njësi e veçantë organizative e brendshme në kuadër të Universitetit "Shën. Kliment Ohër" në Manastir.

Persona juridikë janë pronarë të RA Buba Mara nga Prilepi, RA Sveti Nikollë nga Sveti Nikolla, RA Angels nga Shtipi, RA Buba Mara Studio nga Shtipi dhe RA jofitimprurëse Marija Blagovest nga Strumica.

### 1. RA Buba Mara, Prilep

Pronari i vetëm i këtij radiostacioni është Shoqëria tregtare radiodifuzive BUBA MARA Ranko ShPKNjP Shkup, e cila është në pronësi të personit fizik Ranko Petroviq.



## 2. RA Sveti Nikollë

Pronarët e RA Sveti Nikole janë Shoqata për shërbime intelektuale dhe veprimtari edukative Instituti Ndërkombëtar Sllavjan ShPKNjP Sveti Nikollë, me 88 % të aksioneve, dhe Fondi i Sigurimeve Pensionale dhe Invalidore i Maqedonisë, me 12 % të aksioneve në kapitalin bazë të radios.

Instituti Ndërkombëtar Sllavjan është në pronësi të plotë të Universitetit Ndërkombëtar Sllavjan të Sveti Nikollës, pronari i vetëm i të cilit është personi fizik Jordan Gjorçev.



## 3. RA Angels

Pronari përfundimtar i RA Angels është personi fizik Zoran Iliev, i cili nuk e posedon pronësinë drejtpërdrejt, por nëpërmjet një personi tjetër juridik, përkatësisht përmes Shoqërisë për produksion, shërbime dhe tregti ANGELS PLUS ShPKNjP nga Shtipi.




## 4. RA Buba Mara Studio, Shtip

Ky radiostacion ka pronësi identike me RA Buba Mara nga Prilepi. Pronari i drejtpërdrejtë është radioja rajonale e Shkupit Buba Mara, dhe pronari përfundimtar është personi Ranko Petroviq.




## 5. RA Марија Bllagovest

Radio Marija Bllagovest është radio fetare jofitimprurëse, pronari i të cilit është Shoqata Marija Maqedoni nga Strumica. Si pronarë të shoqatës paraqiten dy persona fizik - Jadranka Çadinovska dhe Ratisllav Kardalev.



Në periudhën nga viti 2022 e tutje, ndryshim të strukturës pronësore kanë kryer katër nga 38 radiostacionet lokale ekzistuese, dhe atë:

1. RA La Kosta nga Vinica – në nëntor 2022, u hoq personi Dafinka Kostadinova dhe hyri personi Branko Ivanovski;
2. RA Red FM nga Tetova – në shtator 2023, u hoq personi Arba Mehmeti dha hyri personi Fjona Mehmeti;
3. RA Kavadari nga Kavadari – në korrik 2024, 30 % e pronësisë së personit Trajanka Mitrova iu bartë (transferua) personit Zllatko Gjorçev; dhe
4. RA Plus Forte nga Tetova – në mars të vitit 2025, u hoq personii Nebojsha Karapejovski dha hyri personi Millan Pavllovski.

Tabela më poshtë paraqet të dhëna mbi pronarët e të gjitha radiove që kanë leje për transmetim të programit në në nivel lokal.

Tabela 8: Struktura pronësore e radiostacioneve lokale në pesë vitet e fundit

<table>
<tr><th>RA</th><th>2022</th><th>2023</th><th>2024</th><th>2025</th><th>2026</th></tr>
<tr><td>RA 106</td><td colspan="5">Kire Hristovski – 100 %</td></tr>
<tr><td>RA Ukllo FM</td><td colspan="5">Universiteti "Shën Kliment Ohridski" Manastir</td></tr>
<tr><td>RA Vallandovë</td><td colspan="5">Snezhana Shuntova – 50 % dhe Dionis Nunov – 50 %</td></tr>
<tr><td>RA Golldi</td><td colspan="5">Maja Çadieva – 100 %</td></tr>
<tr><td>RA Merak 5FM</td><td colspan="5">Dimçe Sazdov – 50 % dhe Ljupço Nestorov – 50 %</td></tr>
<tr><td>RA La Kosta</td><td>deri në nëntor 2022<br>Dafinka Kostadinova – 100 %<br>nga nëntori 2022<br>Branko Ivanovski -100 %</td><td colspan="4">Branko Ivanovski – 100 %</td></tr>
<tr><td>RA Kometa</td><td colspan="5">Zoran Maxhoski – 100 %</td></tr>
<tr><td>RA Tajм</td><td colspan="5">Pavle Jovanovski – 100 %</td></tr>
<tr><td>RA Gallaksi</td><td colspan="5">Nada Angellova – 100 %</td></tr>
<tr><td>RA Kavadari</td><td colspan="2">Trajanka Mitrova – 100 %</td><td colspan="3">nga korriku 2024<br>Trajanka Mitrova – 70 % dhe Zlatko Gjorçev – 30 %</td></tr>
<tr><td>RA Aleksandar Makedonski</td><td colspan="5">Ilija Tanevski – 100 %</td></tr>
<tr><td>RA Akord</td><td colspan="5">Zorica Gjoreska – 100 %</td></tr>
</table>

| | | |
|---|---|---|
| RA Medison | Nada Josifoska – 100 % | |
| RA Koçani FM | Illço Lazarovski – 50% dhe Ilija Stefanovski – 50 % | |
| RA Bum | Suzana Andonoviq – 100 % | |
| RA Jehona FM | Besim Shabani – 100 % | |
| RA Skver | / | Sasha Mitiq – 100 % |
| RA Plus | Marjan Todorov – 100 % | |
| RA Meff | Biljana Joveska – 100 % | |
| RA Holidej | Lence Andonoska – 100 % | |
| RA Пела | Gordana Cvetanoska – 100 % | |
| RA Buba Mara, Prilep | / | nga gushti 2025<br>Shoqri tregtare radiodifuzive BUBA MARA Ranko ShPKNjP Shkup – 100 % |
| RA Еко | Darko Panovski – 100 % | |
| RA Modea | Blagje Monev – 100 % | |
| RA Sveti Nikollë | Sigurimi pensional dhe invalidor Shkup – 12 %<br>Instituti Ndërkombëtar Sllav ShPKNjP, Sveti Nikollë – 88 % | |
| RA Plej | Nikolla Bebekoski – 100 % | |
| RA Struga | / | nga gushti 2025<br>Ansar Alushi – 100 % |
| RA Екspres | Sonja Pojrazovska - 100 % | |
| RA Hit | Stevo Trajkov – 100 % | |
| RA Bleta | Afrim Ramadani – 100 % | |
| RA Kiss | Zoran Todorovski – 100 % | |
| RA Plus Forte | Nebojsha Karapejovski – 100 % | nga marsi 2025<br>Milan Pavllovski – 100 % |
| RA 7 | Enkelejda Shelburne – 100 % | |
| RA Red FM | Arba Mehmeti<br>100 % | nga shtatori 2023<br>Fiona Mehmeti - 100 % |
| RA Angels | Shoqëria e produksionit, shërbime dhe tregti ANGELS PLUS ShPKNjP Shtip – 100 % | |
| RA Buba Mara Studio, Shtip | / | nga gushti 2025<br>Shoqëri tregtare radiodifuzive BUBA MARA Ranko ShPKNjP Shkup – 100 % |
| RA Marija Bllagovest | Shoqata RADIO MARIA MAQEDONI Strumicë – 100 % | |
| RA Impulls | Goranço Tasev – 100 % | |

## NDRYSHIME NË STRUKTURËN PRONËSORE TË TRANSMETUESVE NË VITIN 2025

Bazuar në njoftimet e paraqitura për ndryshim në strukturën pronësore, Agjencia në vitin 2025 miratoi ndryshim në pronësinë e tre transmetuesve - stacioneve televizive Prva Skopska (më emërtim të mëparshëm TV MTM) dhe Shutel, dhe radioctacioni Plus Forte.

1. Nga pronësia e Prva Skopska u tërhoq tërësisht  personi Gordana Andreevska,  dhe hyri personi Nikolla Tasev. Vendimin për ndryshim të strukturës pronësore të këtij transmetuesi, Agjencia  e miratoi në shkurt të 2025, ndërsa ndryshimi u realizua në prill.

2. TV Shutel kërkoi pëlqim për tërheqjen e personit Antonie Stojçeski dhe hyrjen e personit Beadin Sulejmanovski. Edhe pse Agjencia e miratoi këtë ndryshim (në dhjetor 2025), transmetuesi ndryshimin nuk e zbatoi në Regjistrin Qendror brenda afatit të përcaktuar, për këtë shkak Agjencia arriti në përfundim (në mars 2026) sipas vendimit të miratuar më parë me të cilin lejohet zbatimi i ndryshimit në strukturën pronësore nuk prodhon veprim juridik.
3. Nga pronësia e RA Plus Forte u tërhoq personi  Nebojsha Karapejovski dhe hyri personi Milan Pavllovski[4]. Agjencia e miratoi këtë ndryshim në shkurt 2025, ndërsa transmetuesi e zbatoi në mars.

[4] Ndryshimi i pronësisë së RA Plus Forte ndodhi sepse, pas përfundimit të zgjedhjeve parlamentare të vitit 2024, një person që është anëtar i familjes së pronarit të radios u zgjodh për deputet i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, që është në kundërshtim me nenin 38 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele, sipas të cilit *„...bartësitt e funksioneve publike dhe anëtarët e familjeve të tyre nuk mund të kryejnë veprimtari radiodifuzive, as të jenë themelues, bashkëthemelues ose të fitojnë interesa pronësie në transmetues."*

## STRUKTURA PRONËSORE E BOTUESVE TË MEDIAS SË SHTYPIT

Nga gjithsej 19 botues të mediave së shtypit (gjendja nga 22 maji 2026), njëri është në pronësi të plotë të personit juridik, dy kanë pronësi të përzier, përkatësisht pronarët janë njëkohësisht persona juridikë dhe fizik, dhe 14 janë në pronësi vetëm të personave fizik. Dy botuesit e tjerë janë shoqata.

Në pronësi të personi juridik është Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime REPRO PRINT ShPKNjP eksport-import Shkup, botues i gazetës ditore "Nova Makedonija". Pronari i këtij botuesi është person juridik i huaj i themeluar në Ishujt e Virgjër Britanikë, kapitali i të cilit është në pronësi të plotë të personit fizik Minço Jordanov nga Shkupi.




Pronarët e Shoqërisë botuese dhe marketingut SLOBODEN PEÇAT ShPK Shkup, botues i "Sloboden Peçat", janë Vladimir Galjak nga Beogradi dhe Shoqëria për shtyp, distribuim dhe shërbime PEÇAT MK ShPK nga Shkupi. Të dy subjektet kanë pjesëmarrje të barabartë në kapitalin themelues të SLOBODEN PEÇAT ShPK Shkup (secili nga 50 % ).

Pronari kryesor i PEÇAT MK ShPK është personi fizik Dragan Zhivkoviq.




